

NJË SHTET NË RËNIE

Saskia Sassen *

(www.openDemocracy.net: 3 maj 2006) – *Vizioni i Francis Fukujamës dështon në njohjen se sa mangësi i kanë lindur nga brenda demokracisë liberale, thotë Saskia Sassen.*

Pasthënia e Fukujamës në botimin e dytë të librit të tij *The End of History and the Last Man* nga shumë aspekte është një passhkrim i mirëseardhur për argumentin e tij origjinal të para 17 viteve. Fukujama nuk i pranon kritikën që kanë lindur nga një i kuptuar me të meta ose i zvargët i tezës së tij, mirëpo ai pranon se disa kritika meritojnë t'i drejtohen, qoftë nga arsyeja se ekspozimi i tij origjinal ka qenë i paqartë, qoftë nga arsyeja, megjithëse pak më vështirë, se ai ka ndryshuar mendimin e tij pasi historia ka vazhduar të rrjedhë.

Shumica e përgjigjeve të tij më janë dukur bindëse. Më vjen mirë, po ashtu, që ai e kritikon luftën e ShBA-ve në Irak; supozimet e planifikuesve të saj si dhe fatkeqësitë që e shoqërojnë gjendjen e pasluftës; mosdashjen e marrjes në konsideratë të dështimeve të gjithsej afro tetëmbëdhjetë tentativave të ShBA-ve në procesin e formimit të kombit modern që nga vitet e vona të 1800. Këto observime kritike nga një mendimtar kryesor neokonservator kërkojnë guxim dhe mbajnë ngarkesë të shtuar.

Megjithëkëtë unë kam një kundërshtim bazë: trajtimi i demokracisë liberale nga ana e Fukujamës. Ndryshe nga prirja e tij e matur ndaj disa ndryshimeve themelore të disa viteve të fundit, kur vjen fjala te demokracia liberale duket sikur koha po ndalon dhe se nuk bëhet ndonjë histori e re.

Fukujama na përkujton se kur ai fillimisht ka shkruar për demokracinë si fazën finale të historisë, ka menduar në shtetin-komb, dhe se nuk ka përfytyruar ndonjë demokraci

liberale që do të zhvillohej përmes zgjerimit të së drejtës ndërkombëtare. Në diskutimin e këtyre çështjeve ai bën bashkimin e një morie dinamikash, përfshirë edhe një deficit demokratik të shkaktuar nga globalizimi dhe nga dobësimi i shtetit, si dhe nga çarja në rritje midis Evropës dhe ShBA-ve vis-à-vis shtetit-komb. Atij i duket se ShBA-të janë më se të lumtura me tërë konceptin e shtetit-komb dhe të politikave qeverisëse, ndërsa evropianët shtetin-komb e shohin si problematik, e cila gjë parapëlqen që fuqia e butë dhe normat e ligjshme të zëvendësohen nga forca ushtarake në arenën ndërkombëtare. Fukujama nuk e pranon argumentin për demokracinë liberale e cila e kapërcen shtetin-komb.

Fukujama gjithashtu i përgjigjet kritikës për kinse dështimin e tij për të siguruar një teori politike si pjesërisht autonome nga zhvillimi ekonomik. Fukujama tani pretendon se ne duhet ta njohim mundësinë e rënies politike dhe që këndeje edhe faktin se zhvillimi ekonomik vetvetiu nuk do të shkaktojë lindjen e shteteve liberale.

Megjithëkëtë, atë që ai e lë mënjanë në analizën e tij është mundësia e rënies brenda vetë shtetit liberal – dhe konsekuencat shoqëruese të një rënieje të këtillë. Fukujama nuk e merr në pyetje karakterin e brendshëm të shtetit liberal, sidomos në ShBA. Edhe pse ai e kritikon administratën e Bushit për nisjen e luftës së gabuar dhe për dështimin e planifikimit të rikonstruktimit të pasluftës në Irak, edhe pse e njeh rënien e shteteve në disa pjesë

më pak të zhvilluara të botës, ai e harron mundësinë që këtë gjykim ta zbatojë më afër shtëpisë së tij.

Brenda, jo përjashta

Argumentimi i kësaj teme për rënien meriton më shumë hapësirë sesa që kemi këtu, ndaj unë mund t'ia referoj lexuesit të interesuar (ose edhe skeptik) librin tim të ardhshëm *Territory, Authority, Rights: From Medieval to Global Assemblages (Territori, autoriteti, të drejtat: nga kuvendet e mesjetës deri në ato globale)*. Megjithëkëtë, shkurtimisht dy çështje janë qendrore për rastin.

E para është se kjo rënie në shtetin demokratik liberal thjesht nuk mund të shihet si një funksion i deficitit demokratik i shkaktuar nga forcat e jashtme. Fokusimi në forcat e jashtme – me radhë, globalizimi dhe terrorizmi – është metoda më se e zakonitë e sqarimit të deficitit në rritje të qartë në demokracitë liberale.

Ky interpretim i ka pasojat e veta. Fokusimi në forcat e jashtme na pengon neve të mos e hetojmë mundësinë që shteti jo vetëm që i përgjigjet dhe reagon porse edhe potencialisht *prodhon* deficit demokratik. Kërkimet e mia mbi 15 vjeçare rreth globalizmit kanë treguar se globalja është diçka që në shkallë të lartë krijohet *brenda* kombëtares sesa të vijë “nga jashtë”. Aparatura e shtetit është njëra prej anëve kyçe për këtë krijim nën-kombëtar të globales.

Një pasojë tjetër e fokusimit në forcat e jashtme është se ajo s’e vëren dot realitetin e qyteteve globale, të cilat e refuzojnë dyzimin e kombëtares dhe globales si fusha institucionale që e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Ky theksim i së jashtmes si fajtorë për krijimin e një deficitit demokratik mund ta bllokojë të kuptuarit e thellësisë dhe të tipit të transformimit që ndodh brenda shtetit liberal. Në rastin e ShBA-ve ne duhet ta shprehim mundësinë që sjellja ekstreme e administratës së Bushit në disa fusha të

caktuara nuk është thjesht një funksion i presionit të jashtëm ndaj dhe një anomali në funksionimin e zakonshëm të shtetit liberal, porse, në një kuptim të dukshëm, është një faqe e re e shtetit liberal. Nën dritën e kësaj, kërcënimet terroriste dhe lufta në Irak aktualisht mund ta kamuflonjë këtë transformim të thellë, të brendshëm.

Çështja e dytë në argumentimin tim për rënien është kufiri kohor. Ndryshimet themelore brenda shtetit liberal kanë filluar në vitet 1980. Unë ngul këmbë në këtë kontekst të gjatë – i cili përfshinë të dyja administratat, edhe atë demokratike edhe atë republikane në ShBA. Ajo çka dallon te administrata e Bushit është se këto ndryshime janë futur edhe në fushën politike, përderisa në kohën e Ronald Reaganit, George Bush sendorit dhe Bill Clintonit këto ishin të kufizuara në masë të madhe brenda fushës ekonomike dhe teknike. Rëndësia e kësaj qëndron në faktin se sapo ndryshimet të futen në fushën politike ato, së paku pjesërisht, shihen dhe kuptohen më lehtë nga ana e qytetarëve sesa çështjet teknike të çrregullimit ekonomik në tregjet e financave, të telekomunikacionit e të sektorëve të tjerë në vitet 1980-1990.

Leximi im i kësaj historie më sugjeron një neglijencë serioze të kësaj hapësire kohore në të cilën vendimet e marra nga administrata e Reaganit e gërryen Kongresin dhe me këtë krijuan një asimetri të thellë midis pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv. Shumë më shumë kujdes i është kushtuar efektit të çrregullimit mbi rritjen e autoritetit privat sesa largimit nga Kongresi aktivist i viteve 1960-1970 i cili e shkurtoi pushtetin e ekzekutivit dhe i shtoi të drejtat e qytetarëve.

Kongresi e lë pas politikën dhe e bën atë relativisht më publike sesa politikën e pushtetit ekzekutiv. Gërryerja e Kongresit gjithashtu ka edhe efektin e zhvendosjes së funksioneve të ligjvënies e të disa disiplinave të ekzekutivit në pushtetin gjyqësor. Nuk është se këso zhvendosjesh nuk kanë ndodhur edhe më parë, mirëpo

duhet njohur kuptimi dhe efekti i veçantë i tyre në këtë fazë specifike.

Edhe pse i pres me ëndje shumë përgjigje të Fukujamës ndaj kritikave që i janë bërë, mosvënia re nga ana e tij e kësaj rënieje brenda shtetit liberal është një problem më vete. Këto çështje po aq sa edhe qasjet e tij

varen nga tipari qendror i demokracisë liberale si një dinamikë organizuese. Sa këto transformime endogjene për shtetin liberal, dhe jo thjesht të krijuara nga forcat e jashtme, e çatrafillojnë argumentin e tij?

* * *

* Saskia Sassen është profesoreshë në departamentin e sociologjisë në Universitetin e Çikagos dhe në Shkollën Londineze për Ekonomi. Ndër librat e saj bëjnë pjesë: *Losing Control? Sovereignty in the Age of Globalization* (Columbia University Press, 1996) dhe *The Global City: New York, London, Tokyo* (Princeton University Press, 2001). Libri i saj i fundit është *Territory, Authority, and Rights: From Medieval to Global Assemblages* (Princeton University Press, 2006), i mbështetur në një projekt pesëvjeçar mbi qeverisjen dhe përgjegjësinë në një ekonomi globale.

Nga anglishtja:
mr. Rejhan Neziri